



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

ZYRA E KRYETARIT TË OMK  
THE OFFICE OF THE PRESIDENT OF KDC  
KANCELARIJA PREDSIEDNIKA LKK

## **RAPORTI PERIODIK**

15 Dhjetor 2017- 15 Qershor 2018

Prishtinë, Qershor 2018

## Përmbajtja

FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË OMK-SË.....	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	4
PROCESI ZGJEDHOR DHE KONSTITUTIMI I KUVENDIT TË OMK-SË .....	4
ZGJEDHJA E ORGANEVE DHE FUNKSIONALIZIMI ORGANIZATIV .....	4
PËRGATITJA E INFRASTRUKTURËS JURIDIKE .....	5
REGJISTRIMI DHE ANËTARSIMI.....	6
KRIJIMI I BAZËS SË STABILITETIT FINANCIAR .....	6
VEPRIMET PËRGATITORE DHE BARTJA E KOMPETENCAVE PUBLIKE .....	7
THEMELIMI DHE FUNKSIONALIZIMI I ADMINISTRATËS .....	9
PARTNERITETI .....	9
PARTNERËT E BRENDSHËM.....	9
PARTNERËT E JASHTËM.....	10
MARDHËNJET ME PUBLIKUN .....	11
ÇËSHTJET E INFRASTRUKTURËS PËRCJELLËSE.....	12
PLANI I VEPRIMIT PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2018 .....	12

## **FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË OMK-SË**

Të nderuar anëtar të Kuvendit të OMK-së,

Para se të filloj një elaborim të përgjithshëm për priudhën 15 Dhjetor 2017- 15 qershor 2018 të aktiviteteve të mija si Kryetar i OMK-së dhe Këshillit Drejtues të OMK-së, me lejon që të shfrytëzoj rastin që të Ju falenderoj për angazhimin, mbështetjen dhe përkrahjen të rezervë për funksionalizimin e Odës së Mjekëve të Kosovës

Siç edhe jeni në dijeni, OMK-ja i ka themeluar organet e saj në mandatin e parë qysh në vitin 2013. Ndonëse ka kaluar një mandat i tërë, OMK-ja nuk ka arritur që t'i ushtrojë funksionet e saj themelore të cilat janë paraparë me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor. Si organizatë e cila vepron në interes publik dhe e themeluar në bazë të ligjit në fuqi, Unë si Kryetar dhe KD i OMK-së si organe Drejtuese i ka vënë vetës për detyrë që këtë mandat domosdo të bëjë funksionalizimin e plotë të organizatës sonë.

Në këtë Raport, do të mundohem që krahas përshkrimit të gjendjes faktike në organizatë, aktivitetet e Sajë të përshkruajm po ashtu nevojën dhe gatishmërinë që OMK-ja ta ushtrojë funksionin e saj ligjor duke i zbatuar kompetencat publike që janë të parapara dhe të deleguara me legjislacionin në fuqi.

Duke uruar për një bashkëpunim të ndërsjellët, më lejon që të shprehi bindjen dhe besimin e plotë se bashkëpunimi i tillë do të garantojë sukses si në aspektin e menaxhimit të përgjithshëm të OMK-së, ashtu dhe për avansimin e mjekut dhe mirëqenjes së pacientit tonë.

Sinqerisht,

Kryetari i OMK-së

Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.Sci.

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Në bazë të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, respektivisht Nenit 20, paragrafit 1, me nënparagrafin 1.8, Kryetari i OMK-së i raporton Kuvendit të Saj në mënyrë të rregullt në priudha gjashtë mujore apo në bazë vjetore. Ky raport ka për qëllim që të bëjë përshkrimin objektiv të gjendjes në OMK, si në aspektin funksional ashtu dhe në atë organizativ.

## **PROCESI ZGJEDHOR DHE KONSTITUTIMI I KUVENDIT TË OMK-SË**

Pas përfundimit të procesit zgjedhor dhe shpalljes së rezultateve përfundimtare nga ana e KQZ-së, Kryetarja nga mandati i kaluar, Prof.dr. Zylfije Hundozi, sipas autorizimit statutor ka ftuar mbledhjen konstitutive të Kuvendit. Në këtë Kuvend është zgjedhur Kryetari i OMK-së, dr. Pleurat Sejdiu përmes votimit të fshehetë dhe të drejtpërdrejt. Si dhe në bazë të propozimit të Kryetarit të posazgjedhur Kuvendi ka zgjedhur edhe dy zëvendëskryetar, dr. Rrezart Halili dhe dr. Naser Gjonbalaj. Me përfundimin e procesit të zgjedhjes së Kryetarit dhe dy zëvendëskryetarëve të OMK-së është konstituar Kuvendi i OMK-së për të hapur rrugë për themelimin e organeve të tjera të OMK-së.

## **ZGJEDHJA E ORGANEVE DHE FUNKSIONALIZIMI ORGANIZATIV**

Pas konstitutimit të Kuvendit të OMK-së janë krijuar kushtet juridike për të zgjedhur organet të tjera të OMK-së. Kështu që pas dorëzimit dhe pranimit formal të detyrës së Kryetarit të OMK-së, Kryetari i OMK-së ka ftuar mbledhjen e parë të rregullt të Kuvendit të OMK-së për datën 10 janar 2018. Në këtë mbledhje të ftuar nga Kryetari i OMK-së janë proceduar çështjet të rëndësishme për organizatën, duke përfshirë ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për kuotën e anëtarësisë dhe taksave administrative të OMK-së. Po ashtu çështje tjetër e rëndësishme e kësaj mbledhjeje është zgjedhja e organeve kryesore drejtuese të OMK-së siç janë Këshilli Drejtues, Këshilli Mbikëqyrës dhe Këshilli Etik. Me zgjedhjen e këtyre organeve janë krijuar kushtet për funksionalizimin operativ dhe organizativ të OMK-së.

Meqenëse në mbledhjen e parë të Kuvendit ka qenë e pamundshme në kuptim faktik zgjedhja e të gjitha organeve, Kryetari i OMK-së ka ftuar mbledhjen e dytë të rregullt të OMK-së në të cilën janë zgjedhur të gjitha organet siç janë Gjyqi i Nderit, Prokurori i Odës dhe gjashtë (6) Komisionet e Përhershme të Odës. Po ashtu, meqenëse Kuvendi në mbledhjen e parë ka miratuar ndryshimet dhe plotësimet në Statutin e OMK-së për themelimin e Komisionit Statutor si organ i specializuar për interpretimin e dispozitave statutore, në mbledhjen e dytë të Kuvendit është zgjedhur edhe Komisioni Statutor.

Ndërkohë, sipas kërkesës së Kryetarit të OMK-së për të plotësuar kushtet e parapara me legjislacionin në fuqi lidhur me përbërjen e këtyre organeve, Ministria e Shëndetësisë dhe Këshilli Gjyqësor kan deleguar përfaqësuesit e saj nëpër organet e zgjedhura në këtë mbledhje të Kuvendit.

Me themelimin dhe zgjedhjen e të gjitha organeve të parapara me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe Statutin e OMK-së, janë krijuar të gjitha predispozitat për të kosndieruar se OMK-ja posedon kapacitetet e nevojshme organizative për të qenë bartëse e kompetencaave publike të cilat priten që t'i transferohen.

## **PËRGATITJA E INFRASTRUKTURËS JURIDIKE**

Gjandja në fillimi e mandatit e infrastrukturës juridike në OMK relativisht e kompletuar apo mjaftueshëm për fillimin e aktiviteteve themelore të Saj. Pra me rregulloret e miratuara në legjislaturën e kaluar si dhe implementimin e akteve nënligjore të MSH për fushat e kompetencave të bartura dhe ate deri në këtë Kuvend, besoj se kemi përbushur kushtin formalo-juridik për funksionimin e organeve të tilla. Po ashtu, meqenëse sipas Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor në kuadrin e kompetencave publike është edhe miratimi i Kodit Etik, edhe ky obligim ligjor është i përmbushur nga ana e OMK-së.

Duke pasur parasysh nevojën për konsolidim sa më të sforcuar në kuptim të infrastrukturës juridike, Këshilli Drejtues i OMK-së ka autorizuar ekspertin ligjor të angazhuar nga Qeveria e Luksemburgut në Projektin KSV/017, që të fillojë angazhimin për të përgatitur kornizën juridike për të gjitha çështjet që nuk janë të rregulluara me akete normative të OMK-së. Gjithashtu Këshilli Drejtues i OMK-së ka paraparë një sërë aktiviteteve që do të jenë në shërbim të auditimit dhe përpilimit të infrastrukturës juridike, duke përfshirë kontaktet me organizatat të ndryshme që do të mund të ofronin çfarëdo këshillimi bazuar në përvojat e tyre organizative dhe juridike.

Si rezultat i kësaj pune ekipore neve sot kemi para Kuvendit 10 propozime për plotësim dhe ndryshim të Statutit të OMK, projekt Rregullore dhe Vendime .

Poashtu, në zbatimin administrativ të këtyre kompetencave, janë përpiluar një seri aplikacioneve nga të gjitha fushat e veprimtarisë.

OMK, ka ndërrmar dhe ka hartuar draftet e para të dy iniciativave ligjore, ku kemi fituar edhe mbështetjen e Ministrit të Shëndetësisë z. Ismajli, Ministrit të Drejtësisë z Tahiri dhe anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenje sociale. Këto dy iniciativa janë:

1. Ligji mbi të drejtat dhe obligimet e mjekut
2. Udhëzimi Administrativ mbi rregullimin e çështjes së ekspertizave gjyqësore në lëmin e mjeksisë.

## REGJISTRIMI DHE ANËTARSIMI

Pas përgatitjeve të kornizës ligjore, OMK ka filluar regjistrimin dhe anëtarësimin e mjekëve. Procesi ka rrjedhur me një dinamikë të pritur por ka edhe ngecje në disa sektore apo më mirë të themi disa institucione.

Deri me datë 13.06.2018, janë anëtarësuar 3201 mjek.

1. Sektori publik 2939
2. Sektori privat 248
3. Mjekët e huaj 14

Në këtë periudhë, OMK ka bërë edhe printimin dhe fillimin e shpërndarjes së Kartelave të anëtarësisë të cilat për veq tjerave do të synohet të bëjnë të mundur edhe regjistrimin dhe evidentimin automatik të vijimit të anëtarëve tonë në ngjarjet e EVP-së, falë paisjeve përcjellëse elektronike.

## KRIJIMI I BAZËS SË STABILITETIT FINANCIAR

Siç është cekur më lartë në referatin e këtij raporti, Kuvendi i OMK-së në mbledhjen e datës 10 janar 2018 gjegjësisht ka miratuar propozim-vendimin e Kryetarit të OMK-së lidhur me lartësinë e kuotës së anëtarësisë. Në këtë drejtim kuota e anëtarësisë edhe në bazë të dispozitave të Nenit 39 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor si burim kryesor financiar ka pagesën e kuotës së anëtarësisë. Vendimi i miratuar nga Kuvendi, 05.mars.2018, me të cilin është ndryshuar Vendimi i Kuvendit i vitit 2017, kuota e anëtarësisë është përcaktuar në shumë prej 0.8% pagës neto për të gjithë mjekët e punësuar në sektorin publik dhe atij privat, 150.00 €, kurse për mjekët shtetas jokosovar që janë të angazhuar në sektorin privat, 250.00€ për vit kalendarik. Me këtë vendim kanë filluar edhe aktivitetet për të siguruar transferin e mjeteve financiare që janë të grumbulluara nga taksat administrative për licencim dhe rilicencim të mjekëve.

Ndalesat janë bërë nga të ardhurat primare, sipas deklarimeve individuale të bëra në Autoritetet respektive të pagave dhe atyre të tatimeve.

Ky proces nuk ka rrjedhur edhe pa probleme, përkundër që janë parashikuar para dhe gjatë këtij procesi.

Si shembuj:

1. Mangësi në procedimin e listave në plotni nga ana e Departamentit të Pagesave ne MF;
2. Deklarimi jo real i të ardhurave nga mjekët e sektorit privat, pjesa që paguajn 0.8% e rrogës neto;
3. Ikja nga pagesa e nje numri të konsiderueshëm të mjekëve të huaj, si pasojë e hutisë së krijuar nga individ, zyrtar në MSH.

Në këtë drejtim, Këshilli Drejtues dhe Kryetari i OMK-së, kanë marr disa vendime në operacionalizimin dhe realizimin e këtyre pagesave.

Përkundër të gjitha këtyre problematikave, mund të themi lirisht se OMK ka arritur të krijoj stabilitet financiar dhe e gatëshme për planifikim buxhetor të mirë fillt. Prandaj para jush edhe kemi proceduar

Raportin financiar 6 mujore si dhe projekt bugjetin per 6 mujorshin e dytë 2018.

Si përmbledhje e raportit financiar 6 mujorë:

1. Të ardhura	96,058.32 €
2. Shpenzime	46,466.61 €
3. Obligime	11,355.00 €
4. Bilanci	38,236.71 €

OMK, tani më ka hapur xhirollogarinë për Mbështetje dhe Solidaritet, llogari e cila do të shfrytëzohet ekskluzivisht për mbështetjen e anëtarëve tonë bazuar në rregulloret në fuqi.

## **VEPRIMET PËRGATITORE DHE BARTJA E KOMPETENCEVE PUBLIKE**

Ashtu siq edhe kemi premtuar në Kuvendin Zgjidhor, ku kemi prezentuar Planin 6 mujorë, e gjithë puna është përqëndruar në përmbushjen e këtij zotimi apo premtimi duke u kujdesur në fazat implementuese.

I gjithë ky proces që nga konstitutimi i Kuvendit të OMK-së është koncentruar në sigurimin e kapaciteteve për të qenë bartës të kompetencave publike. Kështu që filluar nga themelimi i organeve, krijimi i bazës juridike për sigurimin e mjeteve financiare për projektim buxhetor, rekrutimi i përkohëshëm i stafit administrativ, themelimi i Komisionit të veçantë për bartjen e kompetencave publike në të cilin janë të përfaqësuar MSh-ja dhe OMK-ja, kanë përbërë gamën e veprimeve përgatitore për bartjen e kompetencave publike.

Aset i rëndësishëm i procesit të bartjes së kompetencave ka qenë themelimi i Komisionit për hartim të Planit të Veprimit për procesin e bartjes së kompetencave publike nga MSh-ja tek OMK-ja. Ky Komision tani ka filluar punët dhe ka nxjerrë një raport të detajizuar duke nxjerrë konstatime konkrete dhe duke dhënë rekomandime për hapat konkret lidhur me bartjen e kompetencave.

1. Mbikqyrja etiko-Profesionale
2. Edukimi i vazhdueshëm profesional
3. Licencimi dhe Relicencimi

OMK në këtë drejtim ka filluar dhënjen e Licencave të para si dhe akreditimet dhe mbështetjen financiare për aktivitetet e EVP.

Komisioni për Licencim, deri më tani, që nga 26 prill 2018:

1. Aplikacione për licencim 65
2. Proceduar 46
3. Aprovuar 35

- a. 18 Licencime
- b. 17 Rilicencime

Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional, deri më tani ka pranuar 63 aplikacione:

1. 47 aplikacione për akreditim të pikëve CME, 37 janë aprovuar, 10 janë proceduar drejt për tek Komisioni për Licencim
2. 14 aplikacione për akreditim të programeve, 12 programe të akredituara dhe 2 të tjera në shqyrtim.
3. 5 aplikacione për përkrahje individuale, 1 e aprovuar dhe 4 të rrefuzuara për mosplotësim të kriterëve

Këshilli Etik, gjatë kësaj periudhe ka shqyrtuar:

1. 12 ankesa
  - a. 2 lëndë janë parashtruar
  - b. 2 lëndë kanë kërkuar plotësime dokumentacioni
  - c. 1 lëndë është rrefuzuar për inkompetencë lëndore
  - d. 5 lëndë proceduar Prokurorit të OMK për zhvillim të procedurës hetimore
  - e. 2 lëndë janë në procedurë
2. 66 certifikata për të kaluarën etiko-profesionale
3. 16 Vendime , 6 vendime administrative dhe 10 për lëndë

Prokurori i OMK-së gjatë kësaj periudhe, ka:

1. 7 lëndë të pranuar
2. 3 lëndë të përfunduara
3. 4 lëndë në fazën hetimore ( 2 në fazën e herëshme, 2 në fazën përfundimtare)

Komisioni i përbashkët MSH/OMK ka rifilluar punën për vlerësimin ligjor dhe kapaciteteve institucionale për fillimin e bartjes edhe të kompetencave publike nga sfera e edukimit specialistik dhe subspecialistik. Në këtë drejtim, OMK ka ndërtuar koncept dokumentin për këtë çështje, dokument i cili edhe është edhe është qarkulluar për komente dhe kontribute tek të gjithë anëtarët e Kuvendit. Ky dokument do të paraqitet në mbledhjen e radhës së Komisionit të përbashkët për diskutim.



## **THEMELIMI DHE FUNKCIONALIZIMI I ADMINISTRATËS**

Pas aprovimit nga ana e Këshillit Drejtues të Organigramës, janë rekrutuar me kontratë mbi vepër tre zyrtarë::

1. Asistent ekzekutiv i Kryetarit të OMK-së
2. Zyrtare Ligjore, dhe
3. Zyrtare Administrative për Komisionet e EVP dhe Licencim dhe Relicencim, dhe
4. Zyrtarja financiare e cila vetëm se ka qenë e rekrutuar që nga struktura e kaluar

Këtu i shtohen edhe 4 zyrtarë , ekspert të jashtëm , të alokuar nga Lux-Dev ku bëjnë pjesë

1. Eksperti ligjorë;
2. Eksperti Administrativo- financiar;
3. Eksperti IT-Data-bazë, si dhe
4. Konsulenti i jashtëm për qështje organizative.

Poashtu, këtu duhet të shtojmë se pas aprovimit nga ana e Këshillit Drejtues, në periudha kohore tre mujore, janë angazhuar edhe tre student praktikant.

## **PARTNERITETI**

### **PARTNERËT E BRENDSHËM**

OMK-ja i ka kushtuar rëndësi të veçantë ngritjes së nivelit të bashkëpunimit me partnerët tonë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Në këtë drejtim, OMK ka vazhduar bashkëpunimin me MSH në të gjitha sferat e interesit të përbashkët. MSH, përveq konstruktivitetit të dhënë në procesin e bartjes së kompetencave publike por në kyqjen e vazhdueshme aktive të OMK-së në të gjitha sferat ku edhe është paraparë me ligj. Kështu, MSH ka bërë të mundur që OMK të përfaqsohet në:

1. Bordin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore
2. Bordin për Licencim të Institucioneve Private
3. Këshillin Kosovar për Udhërrëfyes dhe Protokole Klinike
4. Komisionin për përpilomin e:
  - a. Projektligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura

- b. Projektligjin për zyrtarët publik në Republikën e Kosovës, dhe
- c. Projektligjin për paga
- d. Grupit Punues për Hartimin e Planit të burimeve njerëzore në Shëndetësi
- e. Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë
- f. Komisionin për plotësim/ndryshim të Ligjit për Shëndetësi
- g. Komisionin për plotësim/ndryshim të Statutit të ShSKUK-së
- h. Komisionin për përpilimin e Statutit të QKUK-së

Rëndësi të veçantë i kemi kushtuar edhe nxitjen e marrëdhënjëve me Shoqatat profesionale, marrëdhënje të cilat kanë ngecur paksa për arsye të inertivitetit të këtyre të fundit.

OMK ka nënshkruar dy Memorandume Bashkëpunimi me Shoqatën për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve si dhe Shoqatën e Personave që jetojnë në Kosovë me HIV/AIDS

OMK ka zhvilluar një sërë takimesh informuese dhe koordinuese me Bordin e ShSKUK, ku është krijuar një klimë e mirë bashkëpunimi.

## **PARTNERËT E JASHTËM**

OMK, poashtu ka zhvilluar marrëdhënjet me Odat simotra të shteteve si Gjermania, Shqipëria, Sllovenia, Kroacia, BeH, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia dhe anëtarët tjerë të ZEVA-së

Në fund, por jo më pak e rëndësishme, raportet me Lux-Dev kanë qenë të shkëlqyera dhe këta të fundit kanë shprehur kënaqësinë për punën e deritashme të OMK-së dhe kanë shprehë gadishmërinë për mbështetje edhe për shumë vitet e ardhëshme. Jemi duke punuar në përpilimin e projekteve të ardhëshme zhvillimore të OMK-së të cilat Luxemburgu është i gatshëm të i mbështes.

Gjatë kësaj periudhe, neve kemi bërë disa analiza për çasjen strategjike për anëtarësimin e OMK-së në organizata ndërkombëtare, në këtë drejtim ne kemi qenë dhe jemi në kontakte të vazhdueshëm me organizata të fuqishme simotra si dhe konsulatën e Kosovës në Gjenevë për ndërmarjen e hapave të mëtutjeshëm.

Gjatë kësaj periudhe delegacionet e OMK-së kanë marrë pjesë në takime të ndryshme me karakter ndërkombëtar, si:

- a. Takimi i kryetarëve të Odave të Mjekëve nga rajoni i Ballkanit
- b. Pjesëmarrja në Kongresin e Odës Gjermane

c. Takim parapregator të Takimit të Grupit ZEVA

Mediatizimi i aktiviteteve intenzive në funksionalizimin e OMK, ka bërë që të organizohet edhe takimi me Ambasadorin e OSBE-së ku pas takimit u shpreh gadishmëria për ndihmë në ngritje të kapaciteteve njerzore të OMK. Neve menjëhere edhe kemi dorzuar kërkesën për mbështetje në trajnimin e antarëve të Këshillit Etik, Gjyqin e Nderit dhe Prokurorën e Odës

Duhet të përmendim edhe pjesëmarrjen në Tryezen e Rrumbullakët e Sekretares e Pergjithshëme të Komiteti i Përhershëm për mjekëtë Evropës (CPME), Annabel Seeböhm në Tryezen e Rrumbullakët, e cila ka marr përsipër edhe gjetjen e mundësive për anëtarimin e OMK në organizma europian

## **MARDHËNJET ME PUBLIKUN**

OMK i ka kushtuar rëndësi të veçantë mardhënjët me publikun. Në këtë drejtim janë ndërmar një sër aktivitete në promovimin e OMK-së dhe aktiviteteve të Sajë përmes:

1. Intervistave radio dhe televizive
2. Debateve radio dhe televizive
3. Organizim i tryezës së rrumbullakët
4. Raportimi i vazhdueshëm medial të aktiviteteve
5. Organizimi i anketës
6. Lansimi i videos promovuese
7. Takime të vazhdueshme me anëtarët tonë në institucione publike

Në këtë drejtim, vend të veçant zënë themelimi dhe funksionalizimi i faqes zyrtare elektronike e OMK, WEB faqja, kjo falë mbështetjes financiare të Lux-Dev. Tani Faqja është aktive dhe në 'popullim' e sipër. Aktivitetet tona janë të vazhdueshme në promovimin e sajë, përmes së cilës do të bëhet promovimi i OMK-së por edhe lehtësime për anëtarët tonë në qasje të aplikacioneve të ndryshme por edhe ngritjen e transparencës së punës së OMK-së përmes publikimit të Vendimeve, Raporteve të Punës si dhe Raporteve periodike 3 mujore financiare, që edhe është bërë. Këtu kërkohet angazhim isejcilit anëtar të Kuvendit të OMK-së.

## ÇËSHJTJET E INFRASTRUKTURËS PËRCJELLËSE

OMK, ende është duke u përballur me çështjen e lokacionit adekuat, por falë angazhimit tonë dhe gadishmërisë për mbështetje nga ana e Ministrit të Shëndetësisë z. Ismajli dhe Ministrit të Drejtësisë z. Tahiri, kjo problematikë është duke u zgjedhur në mënyrën më të mirë, së paku për një periudhë afatmesme. Por, neve jemi duke vazhduar me angazhimin tonë që përmes gjetjes së donatorve të mundëshëm këtë çështje ta zgjedhim në mënyrë afatgjate.

Deri në këtë periudhë, për çështje logjistike siq janë aparatura elektronike Lux-Dev është duke na mbështetur pa rezervë, mbështetje e cila për shkak të rezultateve dhe punës së bërë gjatë këtyre muajëve të kaluar si duket do të vazhdojë edhe për një periudhë kohore më të gjatë. Prandaj, shfrytëzojmë rastin që të faleminderojmë Lux-Dev dhe zyrtarët e sajë duke siguruar se ky angazhim dhe përkushtim i yni sistematik do të vazhdoj gjatë tërë këtij mandati.

## PLANI I VEPRIMIT PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2018

Krahas pjesës deskriptive të këtij raporti lidhur me aktivitetet që janë ndërmarrë dhe janë në proces e sipër, këtij raporti do i bashkëngjesim edhe Planin e Veprimit për gjashtëmuorin e dytë të vitit 2018. Ky Plan i Veprimit është hartuar nga Kryetari i OMK-së, përmban vetëm aktivitetet shitesë nga ato të cilat konsiderohen si aktivitete të rregullta. Fillimi i krijimit të sistemit informativë/databaze interaktive ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së. Kohezgjatje e projektit – 1 vjet (Lux Dev)

- Dizajnimi dhe fillimi fazës tranzitore të bartjes së kompetencave të edukimit specialistik (zberthimi ligjorë, financiar dhe teknik)
- Krijimi i arkivës digitale (në rast që arrijm të gjejmë donator)
- Adaptimi i aplikacionit për menaxhim të Financave (aplikacion Quick books)
- Organizimi i dy anketave:
  - Kujdesi dhe qasja e mjekut ndaj pacientit, së bashku me PRAK
  - Percepioni i mjekut mbi raportimet e mediave mbi mjekët

- Procedimi në Qeveri i draft Ligjit mbi të drejtat dhe obligimet e mjekut
- Udhëzimi Administrativ mbi rregullimin e çështjes së expertizave gjyqësore në lëmin e Mjeksisë